



Tiranë më, 03.04.2025

V E N D I M

Nr. 6, datë 03.04.2025

Sot më datë 03.04.2025, Keshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, i thirrur nga Presidenti, mori në shqyrtim në rendin e ditës:

- Shqyrtimi i relacionit të Zyrës Juridike, lidhur me organizimin e procesit zgjedhor, për zgjedhjet 2025 të organeve drejtuese të Urdhrit të Psikologut konkretisht, Presidenti dhe Këshilli Kombëtar.

VENDOSI:

1- Të miratojë me 10 (dhjetë) vota Pro, Asnjë Kundër nga anëtarët prezent në mbledhje të Këshillit Kombëtar propozimet e Zyrës Juridike për organizimin e procesit zgjedhor, për zgjedhjet 2025 të organeve drejtuese të Urdhrit të Psikologut konkretisht, Presidenti dhe Këshilli Kombëtar si më poshtë:

1-Të shpallet afati për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhje dhe të administrohet dokumentacioni nga Zyra Juridike sipas nenit 8 të Rregullores të zgjedhjeve.

2-Në përfundim të afatit të caktuar në nenin 5, pika 1, të Rregullores së zgjedhjeve, Zyra Juridike të përfundojë verifikimin e plotësimit të kriterëve nga kandidatët brenda 10(dhjetë) ditësh.

3-Brenda 3(tre) ditëve nga shpallja publike e listës së kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjorë, çdo kandidat i skualifikuar, ka të drejtën e ankimimit në Këshillin Kombëtar. Këshilli Kombëtar shqyrton ankesat sa më sipër brenda 5(pesë) ditëve nga depozitimi i tyre.

4-Ngarkohet specialisti i IT që 24 orë përpara zhvillimit të zgjedhjeve, të printojë listën e anëtarësisë aktive të regjistrit të anëtarësisë së UP, të cilët kanë të drejtë vote, e cila do të shërbejë si listë zgjedhore ditën e zgjedhjeve.

5-Ngarkohet administrata e UP për përgatitjen e fletëve të votimit.

6-Çdo kandidat duhet të autorizojë një vëzhgues jo më vonë se 3 ditë përpara datës së zgjedhjeve, i cili pajiset me autorizim përkatës nga Zyra Juridike.

7-Komisioni Zgjedhor do të përbëhet nga 3(tre) anëtarë të administratës. Komisioni Zgjedhor, merr masa për ngritjen e grupeve të numërimit sipas kategorive të kandidatëve që zgjidhen.

8-Në përfundim të procesit të numerimit të votave, Komisioni Zgjedhor përpilon Proces Verbalet përfundimtare që specifikojnë:

- numrin e pjesmarrësve në votim.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
KËSHILLI KOMBTËAR



- numrin e votave të pavlefshme.
- numrin e votave të vlefshme për secilin kandidatëve në secilën kategori.
- renditjen përfundimtare të kandidatëve për secilën kategori.

9-Komisioni Zgjedhor i përcjellë menjëherë Këshillit Kombëtar procesverbalet e rezultateteve të zgjedhjeve. Brenda 3(tre) ditëve nga përpilimi i proces-verbaleve, çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesa në Këshillin Kombëtar për procesin zgjedhor (neni 9, pika 10 e Rregullores të zgjedhjeve).

10-Këshilli Kombëtar pas shqyrtimit të ankesave, brenda 5 ditëve (neni 9 pika, 11 e Rregullores të zgjedhjeve), pasi shqyrton rregullsinë e procesit, arritjen e kourumit sipas Ligjit 40/2026 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë” neni 15, pika 3, gërma a), vlefshmërinë e procesit, garantimin e standardeve të votimit, respektimin e të drejtës së votimit dhe garantimin e shprehjes së vullnetit nëpërmjet votës, shpall rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve sipas kategorive përkatëse.

11-Këshilli Kombëtar shpërbëhet në momentin e konstituimit të organeve të reja të zgjedhura.

2- Të miratojë me 10 (dhjetë) vota Pro, Asnjë Kundër nga anëtarët prezent në mbledhje të Këshillit Kombëtar se Komisioni Zgjedhor do të jetë i përbërë nga 3(tre) anëtarë, Z.Ervin Mehmetaj, Znj.Arlinda Kërçi dhe Z.Enn Tushe.

PRESIDENTE E URDHRI

Dr. Valbona TRESKA

SEKRETARE

Arlinda KËÇI

